



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 16.

Prishtinë, më 27.04.2015, në ora 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302.

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Valdete Bajrami, Xhavit Haliti, Vjosa Osmani, Time Kadrijaj, Rustem Mustafa, Arben Gashi, Luljeta Veselaj- Gutaj, Ilir Deda, dhe Kujtim Paçaku.

Mungoi : Slllobodan Petroviq.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri, dhe Florent Mehmeti

I ftuar: z. Hajredin Kuçi

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportim i z. Hajredin Kuçi, ministër i Ministrisë së Drejtësisë;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua.

Teuta Sahatqija, kryetare falënderoi ministrin për dërgimin e raportit me shkrim dhe dërgimin e dokumentit tjetër strategjik, duke thënë se secili prej anëtarëve do ta konsultojë dokumentin, kurse më pas ia dha fjalën ministrit Hajredin Kuçi.

Hajredin Kuçi falënderoi për ftesën dhe mirëkuptimin që në mbledhjen e kaluar nuk kishte mundur të marrë pjesë, duke iu përgjigjur ftesës, tha se në bazë të kompetencave do të raportojë për tri çështjet e kërkuara nga Komisioni:

1. Përmbushja e reformave në sistemin e drejtësisë;
2. Çështjet lidhur me Dialogun e Strukturuar për Sundimin e Ligjit në Kosovë dhe
3. Çështjet lidhur me mandatin e EULEX-it.

1. Përmbushja e reformave në Sistemin e Drejtësisë;

Fokusi i Ministrisë së Drejtësisë që nga fillimi ka qenë për krijimin e një arkitekture të mirëfilltë ligjore dhe përcaktimi i standardeve më të larta për drejtësinë në Kosovë, gjithmonë duke qenë të kujdesshëm në kuadër të kompetencave tona për ndarjen e pushteteve dhe kompetencave për ndërtimin e fushës legislative dhe të infrastrukturës për sistemin e drejtësisë. Në këtë kontekst, jemi fokusuar në veçanti në fushën legislative, duke plotësuar një sërë çështjesh që kanë të bëjnë në fushën penale, përfshi hartimin e Kodit të Ri Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, të cilat tashmë janë në fuqi dhe zbatohen në praktikë. Kosova tani ka një infrastrukturë ligjore në këtë drejtim, duke përfshirë edhe Ligjet që kanë të bëjnë me bashkëpunimin juridik, janë hartuar rreth 44 ligje, të cilat kanë për qëllim funksionimin efikas dhe forcimin e sundimit të Ligjit në Kosovë. Gjatë hartimit të këtyre ligjeve kemi qenë të kujdesshëm t'i plotësojmë dy kritere, krijimin e një infrastrukture në përputhje me integritet evropiane dhe ligjet të jenë funksionale për Republikën e Kosovës. Në kuadër të reformimit të sistemit të drejtësisë, është kryer një punë e madhe që ka për qëllim lehtësimin e barrës së gjyqësorit përmes krijimit dhe funksionalizimit të profesioneve të lira: si themelimi dhe funksionalizimi i Sistemit të Noterisë, Sistemi i Ndërmjetësimit, Administratorët Falimentues dhe tani së fundi me miratimin e Ligjit për procedurën Përmbartimore edhe përgatitja e përmbartuesve të parë privatë, të cilët me punën e tyre kanë për ta lehtësuar në masë të madhe punën e gjyqësorit. Puna e tyre duhet ta rris cilësinë për shërbime të qytetarëve dhe të zvogëlojë numrin e lëndëve në gjykatat dhe ta kenë një mbikëqyrje të plotë. Sa i përket ndërtimit të infrastrukturës në sistemin e drejtësisë në Kosovë, në vitet e kaluara janë investuar mbi 100 milionë dhe 35% janë donacione nga partnerët tanë ndërkombëtarë.

Nuk jam marrë me prokurimet për ndërtimet e objekteve por më ka interesuar cilësia dhe koha e ndërtimit. Kemi krijuar hapësira të plota për punë për 6 prokurori publike, kemi ndërtuar hapësira të plota për gjykata në veri dhe kemi ndërtuar 4 burgje, përfshirë burgun për siguri të lartë dhe qendrat e paraburgimit që janë në ndërtim e sipër në Prishtinë dhe Gjilan dhe brenda këtij viti do ta fillojmë ndërtimin e qendrës së paraburgimit në Prizren.

Falënderoj donatorët nga BE-ja dhe SHBA-ja që ndihmuan në realizimin e gjitha këtyre që u përmenden. Pra kemi krijuar kushte që të ndërtojmë një sistem të paanshëm të pavarur, profesional dhe efikas, kjo e fundit duhet të përmirësohet. Kemi ndërtuar dy baza juridike për gjyqtarë dhe prokurorë. E para, emërimi dhe disiplinimi është në tërësi në kompetencën e tyre, dhe Qeveria dhe Kuvendi nuk e kanë asnjë kompetencë. Dua të them se shumë sisteme juridike duke përfshirë edhe anëtarët e BE-së kanë më pak pavarësi në emërim dhe disiplinim se sa ka sistemi ynë juridik.

E dyta, është se kemi ndërtuar bazë të mirë juridike sepse gjyqtarët dhe prokurorët tanë kanë kontratë të përhershme deri në pension pas përvojës tre vjeçare se ekuivalentimi i pagave të gjyqtarëve me atë të Qeverisë ka qenë hap pozitiv dhe me kapacitetet tona presim të kemi ngritje buxhetore të vazhdueshme.

Tani jemi orientuar në fushën civile. Më shumë kemi themeluar Komisionin për Kodin Civil, ku bëjnë pjesë, avokatë, gjyqtarë dhe profesorë dhe kemi marrë një donacion prej 2 milion euro prej BE-së dhe SHBA-së dhe pres që brenda tre viteve Kosova do ta ketë Kodin e vet civil, por në ndërkohë duhet ti bëjë dy gjëra; ti miratojë ligjet e nevojshme dhe ti harmonizojë ligjet ekzistuese.

Këtë mandat e kam definuar besimin në drejtësi, por besimi në drejtësi së pari fitohet duke bërë një ndarje të qartë të pushteteve, jo vetëm në bazën legale por në perceptim dhe realitet dhe këtu duhet të punojmë të gjithë bashkërisht.

2. Çështja e dytë, lidhur me Dialogun e Strukturuar për Sundimin e Ligjit në Kosovë

Ky dialog është një shkëmbim i nivelit të lartë politik për të adresuar sfidat në një fazë të hershme në procesin e zgjerimit. Temat kyçe fokusohen në fushën e gjyqësorit, luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, por në pamundësi të qasjes së drejtpërdrejt në instrumentet e BE-së, dhe kjo është ndoshta specifikë vetëm për Kosovën.

Janë mbajtur 3 takime, dy në Bruksel dhe vitin e kaluar është mbajtur takimi i 3-të në Prishtinë dhe presim që takimi i radhës të mbahet në qershor.

Jo vetëm Qeveria e Kosovës por edhe aktorët tjerë të rendit dhe të ligjit, Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Integritet Evropian do të jenë pjesë e këtij dialogu të strukturuar.

3. Çështje lidhur me mandatin e EULEX-it.

Ne kemi vërejtur dy tranzicione të misionit të EULEX-it, një në vitin 2012 dhe një në vitin 2014, dhe në të dytin ndryshimi ka qenë substancial, kur them substancial, mendoj se kemi pasur dy filozofi, e para që ta ushtrojmë sovranitetin e plotë dhe për një kohë t'i shfrytëzojmë kapacitetet e ekspertëve ndërkombëtarë. Këtu duhet ta kemi parasysh një proporcion, ngritja e kapaciteteve tona dhe zvogëlimi i kapaciteteve të EULEX-it. Në këtë drejtim ua kam drejtuar për mes e-majlit një strategji të asistencës teknike që nënkupton ngritjen e kapaciteteve tona në fushën e drejtësisë. Nuk jam ithtar që të kemi hendek në drejtësi, pra lëvizja dhe shkuarja e EULEX-it të krijojë hendek në institucionet tona, por nuk jam edhe ithtar që EULEX-i të qëndrojë përgjithmonë në Kosovë, prandaj ne duhet t'i marrim përgjegjësit tona dhe në vitin 2016, pres të përfundoj mandatin e vet që është përcaktuar në Kuvendin e Kosovës.

Në kuptim të implementimit kam pasur dy kompetenca, në Departamentin për Mjekësi Ligjore kemi vetëm udhëheqës vendorë dhe në Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, kemi dy ekspert të BE-së që nuk janë nën autoritetin e EULEX-it, por nën autoritetin e Zyrës së Përfaqësuesit të BE-së në Kosovë.

Kemi bërë përpjekje të vazhdueshme dhe çështja e drejtësisë në vendin tonë kërkon një konsensus nacional, jo vetëm në vendimmarrje, por pres edhe mbështetjen, vërejtjet dhe sugjerimet sepse në fund të fundit drejtësia shërben për të gjithë anekënd Kosovës, përfundoi ministri Hajredin Kuçi.

Kryetarja falënderoi ministrin dhe tha se pajtohet me atë se kërkohet një konsensus nacional, të kemi besim në drejtësi si në perceptcion ashtu edhe në realitet. E dimë se kohëve të fundit ka pas dyshime në funksionimin e mirëfilltë të drejtësisë dhe numri i madh i lëndëve të pakryera i ka ndihmuar atij perceptcioni që drejtësia ka nevojë për një trajtim më serioz dhe të vazhdueshëm.

Në Raportin e Progresit theksohet se ka mungesë të ekspertizës dhe ju në diskutimin tuaj treguat angazhimin e juaj për ekspertizë, sidomos me rastin e EULEX-it dhe ngritjes së kapaciteteve për ekspertizë. Na njoftoni nëse keni të shtoni diçka. Po ashtu, rastet e grumbulluara paraqesin një nga shqetësimet kyçe. Gjykatat nuk janë duke zbatuar udhëzimin e KGJK-së për prioritetin e lëndëve të grumbulluara dhe a keni ndërmarrë ndonjë veprim për të rritur numrin e publikimeve të vendimeve gjyqësore, pasi mospublikimi i tyre ngrit shqetësime për transparencën dhe llogaridhënien? Çfarë keni ndërmarrë që sistemi disiplinor për gjyqtarët dhe prokurorët të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare?

Ilir Deda bëri vërejtje që Strategjinë për dy vitet e ardhshme e morëm pak para fillimit të mbledhjes së komisionit dhe asnjë raport i ministrave deri më tani nuk tregon se cilat janë sfidat dhe veprimet për t'i adresuar ato. Prandaj kemi vendosur si komision ta hartojmë një udhëzues për mënyrën e raportimit dhe të t'ua dërgojmë ministrave dhe pyeti :

Kur mund të presim që të procedohet plotësim dhe ndryshimi i 4 ligjeve që janë ndër 9 ligjet, të cilat janë kusht për liberalizimin e vizave . Pse në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për

Këshillin Prokurorial të Kosovës, është paraparë që ministri i drejtësisë të jetë pjesëtar i këshillit pa të drejtë vote. Kjo është ndërhyrje politike në gjyqësor, tha Deda.

Në marrëveshjen për drejtësi në të cilën keni marr pjesë edhe ju, e nënshkruar në Bruksel, pika 13 dhe 14 e kësaj marrëveshjeje, shkel nenin 16 të Kushtetutës së Kosovës.

Pyetja është si keni lejuar që të shkelet Kushtetuta e Kosovës me marrëveshjen për drejtësi.

Pasi që Ministria e Drejtësisë e ka përgjegjësinë direkt për menaxhimin e burgjeve. A dini se ministria është përgjegjëse për mosbesimin e madh që ekziston në këtë pjesë të sistemit të drejtësisë, kur e dimë që komandantët e ndryshëm të luftës dalin pinë kafe, në vend se të rrinë në burg dhe kjo është përgjegjësi direkt e Ministrisë së Drejtësisë

Pyetja e fundit, tha Deda, ka të bëjë me një pjesë të Gjykatës Speciale. Si është paramenduar që Gjykata Speciale të lidh marrëveshje ndërkombëtare në emër të Kosovës pa ratifikim nga ana e Kuvendit të republikës së Kosovës?

Ministri Hajredin Kuçi tha se sa i përket funksionalitetit të Ministrisë së Drejtësisë, keni të drejt të bëni vërejtje se a po i bëjmë ligjet e mira, por në vendimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk e ka asnjë kompetencë Ministria e Drejtësisë dhe shumicën e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor i emëron Kuvendi i Kosovës, të cilit edhe i raporton dhe Ministria e Drejtësisë nuk merr pjesë as fizikisht në ato takime .

Lidhur me ekspertizën që u përmend, tha se kemi problem, sepse është nevoja për ekspertë për çështje financiare, për kibernetikë dhe në Departamentin e Mjekësisë Ligjore për Antropolog, por në këtë drejtim presim ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë.

Sa i përket çështjes së lëndëve të grumbulluara, tha se zbatimi dhe seleksionimi i lëndëve është kompetencë e Këshillit Gjyqësor të gjykatave, por ju kam dhënë një premtim, nëse ata janë të gatshëm që të punojnë tërë ditën dhe të shtunave, Qeveria e Kosovës është e gatshme t'ua bëjë pagesën shtesë .

Sa i përket publikimit, Kuçi tha se pajtohet plotësisht se të gjithë jeni dëshmitarë se në emër të pavarësisë së sistemeve nganjëherë humb llogaridhënia. Me ndryshimin e ligjeve të fundit, kemi paraparë që brenda muajit nga shpallja e aktgjykimit të formës së prerë, aty ku nuk preket privatësia dhe sekretet shtetërore të publikohen në faqet zyrtare të gjykatave të gjitha aktgjykimet dhe kjo do të jetë e obliguar me ligj.

Tek çështja e disiplinimit , asnjë kompetencë nuk e ka Ministria e Drejtësisë në disiplinimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe as në emërimin e tyre.

Ministri drejtësisë sipas detyrës zyrtare ka qenë anëtar i Këshillit Prokurorial, pa qenë unë ministër, por tani kam propozuar të jam pa të drejtë vote.

Për atë që e keni marrë strategjinë me vonesë , jam i gatshëm pasi ta lexoni, të vij dhe të raportoj para jush.

Lidhur me raportimin dhe sfidat, Kuçi tha se kam menduar se duhet raportuar vetëm për tri çështjet e përmendura, por për informacionin tuaj në ueb faqen e internetit i kam publikuar të gjitha sfidat dhe synimet tona.

Sa i përket 4 ligjeve që u përmenden, ai tha se kemi punuar gjatë me këto ligje, por kam pasur dy sfida lidhur me këto, e para ka qenë sepse kam pas kërkesë nga BE-ja dhe partnerët tjerë ndërkombëtarë që mos të procedohen para se të arrihet marrëveshja për drejtësi me Serbinë dhe pengesa tjetër është se që nga viti 2011, kam kërkuar që të formohet Dhoma e Veçantë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, që do të merret me aktakuzat e Prokurorisë Speciale.

Marrëveshja për drejtësi është kompromis politik dhe është brenda neneve të Kushtetutës dhe nuk kanë dal jashtë saj. Ka pasur dy gjëra; ne kemi fituar sovranitetin e ata kanë fituar numrat

dhe ai që bënë marrëveshje bënë edhe kompromis dhe nuk është shkel Kushtetuta. Lidhur me menaxhimin e burgjeve tha se është një prej sfidave më të mëdha .

E kam bërë një ligj, i cili në Kuvendin e Kosovës ka kaluar me konsensus të plotë , kemi themeluar agjencitë e pavarura në burgjet e Kosovës dhe shërbimit korrektues. Si Policia e Kosovës dhe shërbimi korrektues kanë menaxhimin e vet me përjashtim të drejtorit të përgjithshëm të burgjeve që e emëron Qeveria e Kosovës, me propozim timin, asnjë tjetër as s'e emëroj e as s'e disiplinoj. Kam kërkuar hetim për atë që u tha se po ndodh në burgje, por fushëveprimtaria ime më tej është e kufizuar.

Më gëzon një fakt që prej se jam ministër i drejtësisë, asnjë i burgosur nuk ka ik nga burgjet e Kosovës. Në burgjet e Kosovës gjenden më se 1.900 të burgosur dhe nuk kemi asnjë raport për torturime dhe ikje.

Në Kodin Penal e kemi një kapitull të veçantë; ikja nga burgu, që në shumë vende nuk e kanë.

Në fund lidhur me ratifikimin që është bërë dhe që kërkohet për Gjykatën Speciale, Kuçi tha se dokumentet për Gjykatën Speciale, te Presidentja, te Kryeministri dhe te unë kanë ardhur të hartuara nga BE-ja dhe Presidentja e Republikës ka formuar një grup politik dhe një grup teknik, ku bëj pjesë dhe unë, por asnjë pikë nuk është lëvizur pa arritur në Kuvend, pa u votuar.

Vjosa Osmani pati disa pyetje kryesisht për sqarim. Në raportimin tuaj keni përmendur Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve, Ligjin për bashkëpunim juridik dhe Ligjin për avokatin, si një ndër të arriturat e ministrisë, mirëpo, nuk e kisha të qartë se a ka plotësim- ndryshim për to apo janë ato që janë miratuar para disa vitesh, në veçanti për Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe Ligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar. Nëse është bërë apo pritet të bëhet plotësimi dhe ndryshimi në përputhje me Ligjin për Gjykatën Speciale dhe amendamentin kushtetues për Gjykatën Speciale për dy arsye, se parashihen disa rregulla të reja sa i përket mbrojtjes së dëshmitarëve , në veçanti në juridiksion jashtë Kosovës dhe sa i përket bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, parashihet një kompetencë për nënshkrimin e marrëveshjes ndërkombëtare nga këto dhoma të specializuara, apo si do të quhen përfundimisht para se t'i kemi në Kuvendin e Kosovës , sipas nenit 18 të Kushtetutës. A janë bërë këto ndryshime në ligje apo priten të bëhen në të ardhmen?

Pasi e përmenda Gjykatën Speciale, dikush mund të thotë se nuk është temë e sotme, mirëpo, mendoj që së paku deklarativisht është perspektiva jonë evropiane dhe raportet me komunitetin ndërkombëtar po lidhen jashtëzakonisht shumë me çështjen e Gjykatës Speciale, prandaj edhe i bëra pyetjet.

Pasi e udhëhoqi delegacionin teknik dhe bashkëpunoni me BE-në në këtë aspekt, më intereson nëse keni kërkuar dhe sa keni arritur deri tani sukses? Ju thatë që nuk është ndryshuar asgjë, mirëpo siç e dini fjala gjenocid përmendet në një draft ligj që ne e kemi pa dhe duke e ditur se me cilat krime do të merret kjo gjykatë, mendoj se kjo do të ishte kërkesa më esenciale e delegacionit të Republikës së Kosovës dhe nuk do të duhej as të aludohet që ka pas gjenocid.

Na njoftoni se cilat kanë qenë kërkesat tjera esenciale të delegacionit teknik të Republikës së Kosovës në raport me BE-në sa i përket projektligjit të cilin ne e kemi pa.

Sa i përket marrëveshjes për drejtësinë, ju e dini që marrëveshja e 19 prillit, e cila ishte ratifikuar para një kohe në Kuvend, pati paraparë shpërbërjen totale të strukturave paralele, përfshirë edhe ato gjyqësore, pra nuk ka pasur nevojë të pritet marrëveshja për drejtësi që të shpërbëhen ato.

Nga disa raporte të përgatitura nga znj. Edita Tahiri, si duket kjo mbetet një nga sfidat kryesore, andaj shpresoj që mund t' na informoni aq sa keni informata për ato çka po ndodh ne veri me gjyqësorin dhe prokurorinë paralele ilegale?

Në vazhdim Osmani tha se kishte një vërejtje nga familjarët e personave të pagjetur se një ndër pengesat kryesore në zbulimin dhe identifikimin, është mungesa e antropologëve , andaj kërkoj nga ju dhe ministri i arsimit të përgatitni diçka shumë konkrete , në mënyrë që Republika e Kosovës të shkollojë jashtë vendit me përkrahje të partnereve ndërkombëtarë antropologë, të cilët do të mund të kontribuonin në këtë proces.

Në fund Osmani tha se kishte një koment lidhur me marrëveshjet që janë nënshkruar me Serbinë dhe njëra është ratifikuar edhe ne Kuvend. Gjykata Kushtetuese nuk ka thënë asnjëherë se ajo është ne përputhje me kushtetutën , por ka thënë se ajo nuk ka kompetencë ta vlerësoj përmbajtjen e marrëveshjes me Serbinë. E vetmja gjë që e ka vlerësuar, ka qenë procedura e votimit ne Kuvend e jo përmbajtja e marrëveshjes.

Arben Gashi -Ju thatë se as ministri i drejtësisë dhe ministria nuk përziheni ne menaxhimin e burgjeve dhe komplet në sistemin e drejtësisë. A mendoni se kjo është një ikje nga përgjegjësia apo është një metodë më e mirë për te deleguar përgjegjësinë. Siç po vërehet, mungon efikasiteti dhe do të duhej te merret përgjegjësi për menaxhimin e sistemit te drejtësisë.

Kjo çështje ka te bëj me sigurinë e burgjeve dhe riedukimin që bëhet nëpër burgje, cili është ndikimi i sistemit tonë në procesin evropian , a është vlerësuar, kur është krijuar Gjykata Speciale dhe a ka qenë ndikues niveli i ultë i sigurisë ne burgje dhe elemente të tjera që të kërkohej nga Kosova të ketë një Gjykatë Speciale.

Sa për informacion desha te dijë, në debatin e madh që u diskutua për konfidencialitetin apo jokonfidencialitetin e dokumenteve që ju e keni dërguar në komisionin për legjislacion, lidhur me Gjykatën Speciale, a kanë qenë konfidenciale apo jo dhe nëse kanë qenë konfidenciale, çfarë masa janë marrë që te njoftohen që janë dokumente sekrete zyrtare dhe nëse dikush e ka nxjerr sekretin zyrtar, atëherë sa është besueshmëria e institucioneve tona?

Time Kadriaj tha se gjithmonë në raportet e progresit raportohet se sistemi i drejtësisë është një sistem i dështuar dhe gjithmonë Qeveria e Kosovës akuzohet se nuk është bërë mjaftueshëm për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. A do të ndodhë që ne raportimet e ardhshme mos te përsëritet e njëjta çështje, por Kosova ta ketë një sistem te drejtësisë të pakorruptuar dhe të luftohen korrupsioni dhe krimi i organizuar dhe më në fund Kosova ti përmbush standardet në raport me BE-në.

Edhe pse sistemi i drejtësisë është i korruptuar, të gjithë gjyqtarët si persona zyrtarë të lartë të shtetit, përveç kësaj pune janë të angazhuar edhe në dy apo tre punë të tjera shtesë. Sa është efikase që një punë që nuk e kryejnë me përgjegjësi të kanë edhe obligime shtesë? A është fajtores Qeveria e Kosovës për mosluftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, e cila tash po kushtëzohet me formimin e Gjykatës Speciale dhe ne vend se kjo gjykatë të krijohet në Serbi, krijohet ne Kosovë, duke e ditur se Kosova ende po përballlet me gjurmët e krimit dhe në Kosovë janë ende 1.600 persona të pagjetur dhe se Serbia nuk i përmbush obligimet për kthimin e kufomave.

Me Marrëveshjen e 19 prillit, një prej kushteve ka qenë shpërbërja e strukturave paralele në veri të Mitrovicës. Pse nuk po përmbushet kjo pjesë e marrëveshjes sepse shpërbërja e këtyre strukturave është dashtë te kryhet me marrëveshje të drejtësisë, ndërsa tash shpërbërja po kushtëzohet me krijimin e asociacionit të komunave të Kosovës.

Xhavit Haliti theksoi se problemet në drejtësi janë aq të mëdha sa që është e vështirë të diskutohet brenda një mbledhje të komisionit. Besoj që Ministria e Drejtësisë ka informacione të duhura se ku çalon sistemi i drejtësisë dhe dua të besoj që seriozisht do të merret parasysh gjithçka që ka funksionuar keq si dhe gabimet janë bërë që në fillim në sistemin e drejtësisë. Përgjegjësitë janë të adresuara dhe dihen, por mundësitë për ta përmirësuar gjendjen janë të mëdha sepse ne kemi kapacitete profesionale në Kuvend dhe në ministri dhe kemi një universitet që prodhon juristë të mirë dhe ndoshta duhet paraparë që të investojmë me shumë për të nxjerrë juristë të përgjegjshëm dhe me integritet e jo juristë me diploma që fillojnë ta mësojnë jurisprudenten në proces të punës. Me këtë çështje është duke u përballur drejtësia në Kosovë, tha Haliti.

Legjislacioni duhet të plotësohet në shumë çështje, sepse siç thatë e drejta për të ndikuar në Këshillin Gjyqësor është e kufizuar për ministrin, por qenka kompetencë e Parlamentit dhe unë nuk e besoj se këtu ka një deputet që e di saktë se kur mund të përzihet në atë çështje dhe kur mund ta ndryshojë atë. Emërimi i anëtarëve bëhet me formula politike dhe këto bëhen me vota dhe është bërë shumë gabim, prandaj këtu edhe po çalon drejtësia.

Kam dëgjuar për idenë që qendrat e paraburgimit të zvogëlohen ose të hiqen. Unë mendoj që është gabim që qendrat e paraburgimit të jenë të përziera bashkë me qendrat ku kryhen dënimet, nëse të njëjtat gabime qarkullojnë në burgun që mund të jetë i ngjitur me qendrën për vuajtjen e dënimit. Është problematike, sepse ne po dëgjojmë se neper burgje ka drogë dhe qarkullon gjithçka që është e ndaluar dhe këta njerëz që e lejojnë janë njerëz që punojnë nëpër burgje. Jam për sistemin që qendrat e paraburgimit të jenë të veçuara dhe autoritetet që merren me njërin burg mos të kenë të drejtë të futen në tjetrin burg. Kjo është rregull gjithkund.

Ne nga mediat kemi shumë akuza të rënda për sistemin e drejtësisë dhe realisht është vështirë të kërkojmë llogari nga dikush për faktin që gjykatat, duke shfrytëzuar ligjet e Kosovës për pavarësinë e gjykatave kanë krijuar njëfarë lloj pavarësie të lidhur shumë me sistemin korruptiv në nivel vendi, veçanërisht disa nga gjykatat lokale, të cilat bëjnë pazare, dhe pazari është avokati, prokurori dhe gjyqtari. Është mirë që të shohim sistemin vlerësues për gjyqtarë dhe prokurorë, para se të pranohen në punë, por edhe sistemi i kontrollit të funksionojë mirë, qoftë me metoda operative të organeve të specializuara për këtë çështje dhe nuk është në interesin e askujt në Kosovë, mendoj që duhet ta kemi një sistem që të funksionojnë si gjykatat në Evropë, tha Haliti.

Zgjatja e kohës së shqyrtimit të lëndëve është tepër e gjatë dhe duhet të amendamentohen ligjet që kanë të bëjnë me këtë, që lëndët civile dhe lëndët penale të kenë një afat të caktuar se kur duhet të përfundojnë, sepse është bërë praktikë që këto lëndë të lihen në sirtar, apo sipas pazareve dhe lidhjeve që ka dikush, ato ose vjetrohen ose nxjerrën vendimet në kohën kur s'ka nevojë më ose ju ka kaluar afati.

Ne burgjet i kemi për risocializimin e të burgosurve dhe jo për mes sistemit të burgjeve të nxjerrim kriminelë profesionistë dhe zhurma e bërë për këtë ka qenë e panevojshme. Këtu duhet të kemi një kujdes të veçantë, për mënyrën se si i trajtojmë të burgosurit.

Kam informacion se në burgun e Lipjanit, nëpër kontejnerë temperatura verës shkon deri në 50 gradë dhe gardianet e burgut sillen me të burgosurit si me kafshë. Këtu duhet të kontrollohet se a është e mundur të jetohet në këto kushte dhe se gardianët a sillen ndaj atyre njerëzve, të cilët aty janë për risocializim dhe kryerje të dënimit. Lirimi me kusht dhe lirimi i parakohshëm duhet të funksionojë sepse mbajtja e një të burgosuri ka një kosto të caktuar dhe nëse konstatohet se një i burgosur arrin të risocializohet për afatin ligjor, duhet të veprojnë komisionet e veçanta dhe mos

të bëhet që presidentja e vendit ti falë për një vit vetëm dy veta. Nëse është kështu, atëherë mos ta fal asnjërin.

Shumë herë kam dëgjuar se në Kosovë duhet të emërohet një prokuror i ngjashëm me Fallkonen. Jam për këtë se pa pasur një Fallkone të Kosovës, nuk mund të funksionoj drejtësia, nuk mund t'i heqim akuzat për korrupsion nëpër institucionet tona.

Zbrazësitë ligjore duhet të rregullohen brendapërbrenda sistemit dhe mos t'ju lejohej mundësia që shefave të tyre të vendosin për emra të veçantë për të kaluar nëpër pozita.

Në fund Haliti tha se të gjitha të metat që u përmendën, nuk janë çështje krejt e juaj, por janë futur në sistem gradualisht me kohë dhe ju si ministër duhet të përpiqeni që të metat e instaluar, me kohë të përmirësohen sepse drejtësia duhet të jetë tërësisht e pavarur nga politika.

Valdete Bajrami duke e cituar ministrin për kthimin e besimit në drejtësi tek qytetarët, tha se në disa seanca e ka ngritur çështjen për dështim në sistemin e drejtësisë dhe u ndal në rastin e fundit, pikërisht rastin e skandalit të fundit të EULEX-it.

U përmend shumë gjendja e burgjeve dhe e të burgosurve. Më intereson se, si është e mundur që EULEX-i bastis një familje të një të burgosuri, i cili për dy muaj qëndron i burgosur në burgun e Dubravës, kur ju si ministër do të kërkonit llogari në të mirën e qytetarëve, që nga EULEX-i mos të mirrën çështjet e rënda apo skandalet e caktuara me largim të një personi të caktuar, të flijohet ai, i cili ka dhënë një urdhër dhe prapë të vazhdohej kinse rendi dhe ligji po funksionon në pikën më të mirë të mundshme. Ju si ministri pse nuk keni reaguar dhe është për habi kur zyrtarja e EULEX-it del dhe thotë se fajin e kanë organet kompetente të burgut, të cilat nuk na kanë lajmëruar me kohë që ai gjendet i burgosur për dy muaj. Kush do ti bartë pasojat e asaj familjeje që është traumatizuar për herën e dytë, pra çka do të bëni ju, që ta ktheni besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë?

Në raport keni thënë se në Pallatin e Drejtësisë është punuar në sigurimin e kushteve të mira fizike. Të gjithë e dimë se në atë pallat janë investuar mbi 30 milionë euro dhe se ai nuk është duke funksionuar si duhet.

Lidhur me grumbullimin e lëndëve nëpër gjykata, Bajrami pyeti se si është ndërtuar politika për evitimin e këtyre probleme dhe mangësive të tjera në sistemin e drejtësisë.

Hajredin Kuçi tha se u përmend çështja për Ligjin për dëshmitarët dhe Ligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar. E dimë se është propozuar një ligj special, i cili do të përfshijë ligjet e veçanta. Sa i përket Gjykatës Speciale, nuk jam zëdhënës. Ne si grup teknik ia kemi dhënë Komisionit për Legjislacion 18 vërejtjet tona profesionale dhe jam i gatshëm t'ua përcjell ato edhe juve dhe se vërejtjet tona janë dhënë me kohë dhe janë publikuar në gazetën "Koha ditore".

Unë e kam marr masën që e kam shënuar në dokument si konfidencial dhe ua kam dërguar në "hard copy" dhe këtë e ka kërkuar BE-ja.

U përmend marrëveshja për drejtësi. Do të përmendi dy fakte; sovraniteti në veri nuk është ushtruar dhe këtë duhet ta pranojmë dhe e dyta, pafuqia jonë e ushtrimit të sovranitetit, por edhe faktori ndërkombëtar nuk e ka pasur vullnetin, me e shtri sovranitetin atje dhe Serbia ka pasur një ndërhyrje të drejtpërdrejt dhe këta 3 faktorë janë bërë së bashku dhe kanë bërë një marrëveshje tjetër. Edhe marrëveshja e 19 prillit dhe marrëveshja për drejtësi, nëse nuk tërhiqet Serbia mos me u përzi dhe faktori ndërkombëtar nuk determinohet dhe nëse ne nuk jemi më të vëmendshëm prapë ajo nuk do të implementohet.

Sa i përket kushtetutshmërisë për marrëveshjen me Serbinë, Gjykata Kushtetuese është e vërtetë që ka thënë se nuk është në përputhje me kushtetutën, por është e vërtetë që ka thënë që është në kundërshtim.

U përmend pjesëmarrja e ministrit. Unë vet kam propozuar që ministri i drejtësisë me qenë vetëm vëzhgues, dhe do të propozoj mos me qenë fare, dua të kërkoj me na nda llogaridhënien edhe pavarësinë.

Sa i përket antropologëve, ne i kemi nda dy bursa që t'i përgatisim, e kemi pas edhe një projekt me IPA-në, por kërkon shumë kohë deri sa t'i përgatisim dhe kërkon buxhet gjithmonë shtesë. Besoj që brenda vitit do të përgatiten dhe të kthehen për të punuar.

Lidhur me pyetjet e z. Gashi tha se ne e kemi bërë një burg te sigurisë së lartë me standarde me të mira ndërkombëtare, por Kosova kurrë nuk ka pasur të burgosur më të rëndë në burgjet e veta se sa ka në këto vite. Mbi 100 vetë janë mbi 15 vjet të dënuar. Lidhur me çështjen e amnistisë dhe faljes, e kam propozuar një ligj, por ma kanë kthyer në Kuvend. Brenda muajit maj do ta propozoj edhe një ligj në Kuvend për amnistinë, por për mua risocializimi është qëllim i dënimit dhe për mua është e papranueshme që për një vit të falen dy veta e vitin tjetër asnjë.

Kam propozuar që për korrupsion, narkotik, trafikim me qenie njerëzore mos të amnistohen, por për vepra tjera. Unë besoj se me stimulim arrihet suksesi, sepse ne kemi punëtorë socialë dhe panel për lirim me kusht.

Sa i përket Pallatit Drejtësisë asnjë kompetencë nuk e kam pas përveç që e kam siguruar buxhetin prej BE-së dhe Qeverisë së Kosovës dhe nuk jam marrë me te. Ministria e Administratës Publike e ka në menaxhim atë...

Lidhur me luftën kundër korrupsionit janë tre faktorë: ligjet janë faktorët që implementojnë dhe faktori social.

Kosova i ka ligjet më të mira në rajon, 44 ligje mandatin e kaluar dhe këtë mandat i kam proceduar që kanë të bëjnë me këtë luftë. Implementimi është me rëndësi, por i ka dy përgjegjësi, emërimin e anëtarëve e bën Kuvendi, Këshilli Gjyqësor e bën raportin vjetor. Mos e miratoni nëse mendoni që nuk është në rregull. Sa përket faktorit social që u përmend, e di që në vendet e rajonit është luftë dhe faktori social ka ndikim të madh, por ndikimi kulturor është me ndikim të madh në këtë vend, më tepër se ai politik.

Sa i përket çështjes lidhur me emërimin e anëtarëve, ky vend vuan në emër të pavarësisë së sistemeve në llogaridhënie. Neve partnerët ndërkombëtarë duke na frikësuar që mos të përzihehi shumë, na kanë largu më tepër se që duhet dhe sot në këtë vend nuk e di se kush është përgjegjës për luftën kundër korrupsionit.

I kemi 7 institucione dhe asnjëri prej nesh nuk e ngit zërin se kush është në këtë vend, por secili thotë shko te ky shko te ai dhe ne duhet t'i harmonizojmë. I vetmi vend demokratik në botë është, ku Zyra e Prokurorit Disiplinor emërohet nga ai që ka me i disiplinua në Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial. Imagjinoni nëse ai fillon ta inspektojë dikë nga ata. Do ta kërkojnë shkarkimin e tij. Silleni në Kuvend dhe unë do ta sjell propozimin me 2/3 e votave dhe zgjidheni, por të jetë i pavarur.

Nuk ka vend demokratik në botë që njëri shkallë nuk e ka ose në emërim ose në disiplinim.

Sa i përket përgjegjësisë, njerëzit tanë në emër të faktorit ndërkombëtar i kanë ik përgjegjësisë, prokurorët tanë dhe gjyqtarët nuk kanë dalë në vijë të parë të frontit dhe transicioni i EULEX-it ka për qëllim që ata të dalin në vijë të parë të frontit. Jam për atë që t'i bartim përgjegjësitë. Unë jam për sundimin e ligjit dhe ligji vlen edhe për EULEX-in dhe për të gjithë dhe për çdo lloj skandali, hetimet ata i kanë dhe kompetencat që nuk na përgjigjen neve, por duhet ti shkojmë deri në fund.

Tek çështja e paraburgimit, ne kemi raste që 30 % të qendrave tona kanë paraburgim dhe kemi qenë të detyruar që në mungesë të hapësirës ti vejmë në një vend dhe ka qenë sistem që e kanë bërë burgjet në mes të qytetit, gjë që është gabim, por me ndërtimin e Pallatit të Drejtësisë disa gjëra do të rregullohen. Unë nuk kam marr raport që ka keqpërdorime ndaj të burgosurve, por në çdo qendër të burgimit kemi vendosur kuti për ankesa dhe nuk ka të burgosur që me dërgon letër e që unë nuk i përgjigjem.

Tek çështja e efikasitetit se nuk ka besim në drejtësi, ne i kemi bërë dy gjëra dhe në kushtetutë thuhet, çështjet duhet të zgjidhen në afatin e arsyeshëm kohor dhe në këtë vend asnjë avokat nuk e ngrit çështjen pse nuk po zgjidhen lëndët në afatin kohor dhe e dyta kemi dhënë dënime alternative dhe unë nuk kam kërkesa prej njerëzve dhe avokatëve për marrjen e dënimeve alternative. Të gjithë mendojnë se duhet me i dërgua në paraburgim. Tani do ta bëjmë monitorimin elektronik dhe për mua është shpenzim i madh sepse 28 euro i kushton buxhetit të Kosovës një i burgosur apo i paraburgosur dhe kjo është shumë e madhe.

U përmend edhe çështja e pjesëmarrjes në Këshillin Gjyqësor. Do të doja pavarësinë e plotë, paanshmërinë e plotë, profesionalizmin dhe guximin, në vlerësim, gjithnjë i bëjmë kushtet formale por në integritet është mirë ti shikojmë edhe gjyqtarët edhe prokurorët. Integriteti nënkupton edhe punën edhe profesionalizmin dhe gatishmërinë me u përball me veprime që nuk janë gjithaq të lehta.

Për rastin e fundit të EULEX-it, unë jam ithtar që hetimet dhe drejtësia me shkua deri në fund dhe çdo ligj që e propozojmë dhe çdo veprimi imi ka dy balance; drejtësinë dhe të drejtat e njeriut. Për rastin e fundit i kam shkruar letër shefit të EULEX-it, drejtorit të shërbimit korrektues, kryeinspektorit, që të kryej hetimet dhe të shohim se ku ka qenë ngecja, sa i përket të drejtave të njeriut, ju premtoj juve dhe secilit qytetarë se çka është në kompetencë të ministrit të Drejtësisë do të reagojë qind për qind.

Kurse sa i përket Pallatit të Drejtësisë më vjen keq që ka lëshime dhe probleme, por nuk është asnjë kompetencë e Ministrisë së Drejtësisë. Unë e kam bërë projektin dhe e kam dërguar në Bruksel dhe e kam siguruar buxhetin prej Qeverisë dhe çështjet e menaxhimit janë çështjet e tjetërkujt dhe aty duhet bërë një kontroll edhe për çështje të menaxhimit dhe të projektit.

Më vjen keq pse nuk janë krye dhe për çdo shqetësim që ju ka ndodhur njerëzve në Pallatin e Drejtësisë. E di se çdo fillim është i vështirë dhe jam i bindur se ai pallat për pak kohë do të funksionalizohet dhe Ministria e Drejtësisë nuk është pjesë e asnjë investimi kapital.

Lidhur me kthimin e besimit të qytetarëve në drejtësi, së pari duhet të krijojmë ambient të plotë për pavarësinë të gjyqtarit nga politika dhe nga ndikimet kulturore.

Duhet te kemi kujdes me efikasitetin sepse fokus shumë më të madh duhet të kemi në lëndët civile, sepse kemi të bëjmë me çështjet pronësore.

Jam i bindur se me hapjen e mundësisë për Këshill të Evropës, shumë palë do ta fitojnë të drejtën në emër të asaj që u janë shkelur drejtat e njeriut, vetëm se nuk janë kryer në afatin kohor dhe ne duhet të bëjmë presionin publik, jo si e merr vendimin, por pse nuk e merr ndaj individëve apo kujtdo tjetër.

Në fund, sa i përket integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, te seleksionimi, Kosova mund ta ndërrojë imazhin me 10 prokurorë dhe gjyqtarë të mirë dhe unë ju ftoj t'ma jepni mbështetjen në Kuvend, për ta bërë një dhomë të veçantë në Prishtinë dhe përveç fakultetit dhe provimit të jurispodencës duhet prokurori dhe gjykatësi ta ketë edhe guximin qytetar sepse unë e di se aty ka shumë njerëz që punojnë. Ata janë njerëz të ndershëm dhe profesional dhe duhet t'i seleksionojmë pozitivisht.

Rrustem Mustafa theksoi se numri i përgjithshëm i të burgosurve në vend është shqetësues për të gjithë, sepse kjo tregon se nuk kemi krijuar ambient të mirë për drejtësi dhe neve na mbetet ta krijojmë një ambient më të mirë politik, dhe kjo e ka shty krijimin e Gjykatës Speciale.

Sa i përket draft strategjisë që njoftuat për largimin e EULEX-it, nga kompetencat dhe mbajtjen në asistencë, sugjeroj që ka një debalancë, sepse ne gjendemi para një momenti kur duhet të votojmë për një gjykatë speciale dhe në anën tjetër, a jemi të gatshëm si vendorë për të marrë përgjegjësitë e duhura dhe të largohet EULEX-i.

Mendoj se ne duhet të kërkojmë asistencë të përhershme dhe më të shtuar, por duhet të kemi adresa që na asistojnë. Kisha dashur të vinë nga një apo dy shtete që kanë kredibilitet të lartë, në rend dhe drejtësi në shtetin e tyre, në mënyrë që edhe ne ti kuptojmë më lehtë.

Pas të gjitha atyre që u thanë nga ministri erdha në përfundim që të krijojmë një model të drejtësisë në vend, qoftë për gjykata, burgje dhe sektorët tjerë, duke mos i ikur përgjegjësisë që e thatë edhe vet, sepse keni krijuar asi politike që askush nuk e gjen veten të obliguar për shumë çështje të rëndësishme që duhet marrë, andaj pres nga ju dhe Qeveria që te emëroni njerëz adekuat me kredibilitet të lartë në të gjitha drejtimet, që të merren me kompetencë për punët e veta...

Ilir Deda – Ju si ministër keni funksion politik dhe përgjegjësi politike dhe nuk mund të flasim tani se ndërkombëtarët po i bëjnë gjërat dhe na po rrimë dhe po këqyrim. Nëse flasim në atë rrafsh, ne atëherë, më 17 shkurt 2008, çka paskemi bërë, 16 vite po na shkojnë duke u arsyetuar se dikush po na vjen po na bien ligje, atëherë pse ekziston grupi teknik për gjykatë speciale dhe grupi që ju e udhëhiqni dhe nëse askush nuk do ti merr parasysh pse i keni dhënë vërejtjet dhe pse po e humbim hapin.

Marrëveshja për drejtësi e shkel Kushtetutën e Kosovës dhe ju keni përgjegjësi ta respektoni kushtetutën si të gjithë ne. Si keni mundur në një rajon të Kosovës me e nda strukturën etnike të të punësuarve, të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Si mundët ta pranoni, jo çka ka dashtë Brukseli, sepse ju e keni drejtuar atë. Prapë është shkelje e Kushtetutës të gjykata speciale, si keni pranuar që gjykata me lidh marrëveshje ndërkombëtare të tjera dhe Kuvendi i Kosovës mos me e ratifikua.

Vjosa Osmani - Ju ministër e përmendet një çështje që fatkeqësisht nuk përmendet shumë në institucione dhe ajo ka te bëjë jo vetëm me të drejtën penale por edhe civile. Ne në Kuvend po presim ardhjen e draftëve të reja që do të harmonizojnë të drejtat pronësore, por edhe çështjet e tjera, por në veçanti çështja e të drejtave të njeriut nga aspekti i të drejtës civile, sepse shumë nga lëndët që inicohen nga qytetarët e Kosovës, qytetarët humbasin të drejtat e tyre sepse nuk realizohen me kohë, andaj kam një kërkesë specifike, e cila nuk ka gjet mirëkuptimin në Ministrinë e Financave, por duhet ta ketë mirëkuptimin e çdo juristi.

Është iniciativë e 13 mijë qytetarëve për ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike, e para e kësaj natyre në republikën e Kosovës. Kodi Penal, ligji i detyrimeve e njohin të drejtën jo vetëm për kompensimin material por edhe të drejtën e kompensimit jo material dhe është e drejtë që është shkelur. Ka vendime të tëra të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut të cilat sipas nenit 53 të Kushtetutës, e kemi për obligim ta respektojmë dhe Ligji për menaxhimin e financave publike ua ka mohuar këtë të drejtë dhe kjo iniciativë qytetare kërkon që kjo padrejtësi të evitohet dhe të njihet edhe me këtë ligj.

Nëse ju si ministër i drejtësisë e përkrahni këtë iniciativë qytetare edhe unë do ta përkrahi iniciativën tuaj, që të bëhen ndryshimet e nevojshme për themelimin e Dhomës së Veçantë dhe shpresoj që në seancën e radhës të trajtohet kjo iniciativë qytetare dhe është mëkat të dëgjojmë argument se nuk ka para.

Ministri iu përgjigj z.Mustafa duke thënë se sa i përket krijimit të ambientit për drejtësi jam i bindur se nuk është me rëndësi kush është ministër i drejtësisë sepse nuk ka lidhmëni shumë ambienti me individin, por ambient duhet krijuar pozitiv- opozitiv, sepse nuk ka drejtësi selektive.

Sa i përket mbikëqyrjes ndërkombëtare, Unioni Evropian le ta rrit llupën. Nuk mendoj se EULEX-i duhet të lëshoj Kosovën pa i ngrit kapacitetet tona, por ata duhet ta kenë një qendër të vendimarrjes.

Është e vërtetë se duhet me pas një model, por secili donatorë na e ka prurë shkollën e vet, në ngecje e sipër e kam bërë rishikim e situatës së drejtësisë që ka dy qëllime: harmonizimin e institucioneve dhe harmonizimin e ligjeve dhe drejtësia duhet të kuptohet si drejtësi. Duhet të jemi të kujdesshëm dhe njeriun e sigurt duhet ta mbrojmë dhe nuk guxon njeriu i ndershëm të frikësohet. Unë e kam hartuar një ligj që ka problem me financat e që është Ligji për kompensimet e viktimave të krimit. Nuk mjafton se nëse dikujt iu ka thyer shitorja, nuk mjafton të themi se e kam zënë hajnin dhe e kam dënua, por me ja kompensua dëmin.

Në vazhdim, Kuçi tha se menaxhimi i rasteve që ndërlidhen me krimet e luftës, 16 vite pas luftës qind për qind prokurorët, hetuesit dhe gardianet kanë qenë të EULEX-it.

Sa i përket 4 ligjeve që kanë të bëjnë me liberalizimin e vizave janë të gatshme dhe po presin dritën jeshile nga BE-ja, kurse sa i përket Gjykatës Speciale i kemi dhënë vërejtjet me shkrim. Tash ato vinë në Kuvend, ato vërejtje që u përmenden për ratifikimin e marrëveshjes pa pëlqim të Kuvendit, që lidhet me nenin 18 dhe 20 të Kushtetutës, janë gjëra që pastaj vendos grupi politik dhe cilin vendim që e merr do ta duartrokas dhe 18 vërejtjet e dhëna së shpejti do t'jua dërgojmë në komision.

Valdete Bajrami tha se në Komisionin për legjislacion ministër keni deklaruar se Gjykata speciale nuk do të garantojë barazi të palëve, duke e pas parasysh se atëbarazi e garanton çdo dokument ndërkombëtar dhe Kushtetuta jonë dhe nëse në këtë rast nuk e garanton prapë është shkelur Kushtetuta jonë.

Hajredin Kuçi- Atë çka e kam thënë kam qenë plotësisht i hapur dhe janë disa raste që edhe ne i kemi vërejt dhe këto duhet të korrektohen. Nëse Gjykata Speciale është veprim politik, përmbajtja e saj duhet ta ketë një ndryshim të tillë, kur ti merrni ato 18 vërejtje me shkrim do të vëreni se i kemi dhënë vërejtjet dhe i kemi dhënë edhe arsyetimet tona, pse nuk është diçka në rregull dhe ligji ka dobi retroaktivisht kur shkon në dobi të palëve, e jo në dëm të tyre.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Znj.Teuta Sahatqija